

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 967, DATË 25.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE’”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është ndryshimi dhe riformulimi i detyrave të Komitetit në përputhje me detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

Në funksion të qartësisë së përbërjes që ka sekretariati teknik, propozohet dhe riformulimi i pikës 9/1, ku specifikohet se përbërja e sekretariatit teknik përcaktohet/miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin, në varësi të çështjeve që do të trajtohen në Komitet.

Gjithashtu, propozohet shfuqizimi i një pjese të detyrave të Komitetit, të cilat nuk gjejnë mbështetje në akte ligjore apo nënligjore në fuqi, në fushën e mbetjeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2022, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi i propozuar do të qartësojë gjithashtu detyrat funksionale të Komitetit në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, si

dhe përbërjen e sekretariatit teknik, i cili do të miratohet me urdhër ministri. Kjo për arsye se, në varësi të çështjeve që do të trajtohen në Komitet, Ministri do të nominojë në përbërje të Sekretariatit teknik, specialistët përkatës të fushës që do të mbulojnë çështjet që do të diskutohen në Komitet.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Rishikimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërcituar bëhet në përputhje me programin e qeverisë, i cili ka në fokus të veçantë mjedisin në tërësi dhe adresimin e problematikave të çështjeve të mbetjeve në veçanti.

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe pikën 15, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektvendimi i propozuar nuk synon përafrimin dhe transpozimin e asnjë direktivë apo rregullore të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi pëson ndryshime në disa pika dhe konkretisht:

1. Titulli i vendimit të Këshillit të Ministrave ndryshon me përmbajtjen si vijon: “Për përbërjen e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve si dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të tij”.

Ndryshimi i referohet parashikimit të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, ku parashikohet: *Për të bashkërenduar detyrat e ministrave për menaxhim të integruar mjedisor të mbetjeve, krijohet Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, si organizëm ndërministror, në nivel zëvendësministrash. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton përbërjen dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të tij.*

2. Shkronjat c), dh), e) dhe ë), të pikës 4 të këtij vendimi, propozohen të shfuqizohen, pasi parashikimet e shkronjave c) dhe dh), që lidhen me shpalljen dhe përfundimin e emergjencës mjedisore si dhe krijimi i task-forcës mjedisore në rastet e emergjencës mjedisore, nuk gjejnë mbështetje në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi, në fushën e mbetjeve. Referuar legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe atij për menaxhimin e integruar të mbetjeve, nuk është e parashikuar terminologjia e “emergjencës mjedisore” si dhe kriteret/kushtet ku mbështetet shpallja apo përfundimi i saj nga Komiteti.

Gjithashtu, shfuqizimi i shkronjës e) të pikës 4, që lidhet me krijimin e Grupit Kombëtar Këshillimor për Mbetjet (GKKM), propozohet pasi gjatë zbatimit të këtij vendimi, ky grup nuk është ngritur ndonjëherë dhe nuk është parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbetjet, konkretisht në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, të miratuar në vitin 2020 dhe as në ligjin kuadër të menaxhimit të mbetjeve, të miratuar në vitin 2011.

Sa i përket propozimit për shfuqizimin e shkronjës ë) të pikës 4, sqarojnë se parashikimi i kësaj pike, krijon paqartësi në identifikimin e funksioneve që mund të kryejë Komiteti, por dhe që nuk janë kompetencë e institucioneve të tjera. Theksojmë se roli i Komitetit është vetëm ai i bashkërendimit të detyrave të ministrive për menaxhimin e integruar të mbetjeve, dhe nuk mund të dalë mbi fushën e veprimtarive të institucioneve, që janë pjesë e Komitetit.

3. Pika 9/1, riformulohet me përmbajtje si vijon: Mbledhjet e Komitetit organizohen dhe asistohen nga sekretariati teknik, përbërja e të cilit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

4. Në pikën 10 fjalët “...apo me situatat emergjente mjedisore të krijuara” hiqen, referuar argumentit të dhënë më sipër në pikën 2, të këtij kreu.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe institucionet e përmenduara në pikën 2 të projektaktit, sipas fushave të përgjegjësisë që ato kanë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e projektvendimit kanë kontribuar ekspertë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Projektvendimi është diskutuar nga anëtarët e Komitetit, të caktuar nëpërmjet Urdhërit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 284, datë 06.12.2021 “Për ngritjen e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”.

Gjithashtu, projektvendimi do të dërgohet për mendim nëpërmjet sistemit e-akte në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk sjell shpenzime shtesë buxhetore, pasi strukturat që do të angazhohen për zbatimin e këtij vendimi, janë të ngritura e funksionale dhe nuk do të kërkojnë shtesë buxheti.

**MINISTËR**
Mirela KUMBARO FURXHI